



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0559**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vjosa Gradinaj-Mexhuani - Kryetare, Isa Hasani si dhe Vedat Poterqoi Anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së OE "Pylla" SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dru dhe pelet” me numër të prokurimit 651-23-4592-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK)–Komuna e Gjilanit, më 17/11/2023, mori këtë:

## **Vendim**

1. Aprovohet pjesërisht ankesa e OE "Pylla" SH.P.K. me nr. 2023/0559, e datës 09/08/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dru dhe pelet”, me numër të prokurimit 651-23-4592-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Gjilanit., kurse mbetet në fuqi vendimi i AK për dhënie i datës 25.07.2023.

2. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues OE, aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me 15.05.2023, Komuna e Gjilanit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me dru dhe pelet” me nr. të prokurimit: 651-23-4592-1-1-1. Ndërsa me datën 29. 06. 2023, AK ka publikuar B58 – Njoftimin mbi vendimin e AK.

Operatori ekonomik “Pylla” ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim me datën 03.07.2023, ndërsa AK me datën 10.07.2023 ka aprovuar pjesërisht kërkesën për rishqyrtim.

Pas rivlerësimit, me datën 25.07.2023, AK ka publikuar B58 – Njoftimin mbi vendimin e AK.

OE "Pylla" SH.P.K. me datën 28.07.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ndërsa AK me datën 02.08.2023 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim te OE ankues.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE "Pylla" SH.P.K., me datën 09.08.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2023/0559, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

*-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Pylla" SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

***Pretendimi*** Ankuesi pretendon se “Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjilanit - Departamenti i Prokurimit nuk e ka respektuar nenin 7 të LPP-së.” ***Pretendimi i dytë (II) dhe i katërt (IV):*** Ankuesi pretendon se “Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjilanit - Departamenti i Prokurimit nuk e ka respektuar nenin 59 dhe nenin 72 të LPP-së.” ***Pretendimi i tretë (III):*** Ankuesi pretendon se “Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjilanit - Departamenti i Prokurimit nuk e ka respektuar nenin 62 pika 1 dhe 1.1 të LPP-së.” ***Pretendimi i pestë (V):*** Ankuesi pretendon se “Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjilanit -Departamenti i Prokurimit nuk e ka respektuar nenin 69 të LPP-së.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE "Pylla" SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59, 62, 69 dhe 72 të LPP duke kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 11/08/2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 559/23, ndërsa me datë 17/08/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0559 me rekomandimet si në vijim: “Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.”

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK pajtohet rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE ka deklaruar se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

*- Administrimi dhe vlerësimi i provave -*

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "Pylla" SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0559 ka vlerësuar si në vijim:

**Pretendimi i parë (I) ankimor është i pa bazuar** pasi që *“Eksperti thekson se ndër të tjera qëllimi i këtij neni është që autoritetet kontraktuese do të trajtojnë të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë pa diskriminim si dhe me transparencë, gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit. Pretendimi i OE ankues lidhur me shkeljen e këtij neni është përmendur vetëm sipërfaqësisht pa e specifikuar se çka nuk ishte në harmoni me nenin 7 të LPP-së. Eksperti sqaron se me rastin e ekzaminimit të lëndës nuk është vërejtur se AK ka bërë ndonjë veprim që bien ndesh me nenin 7 të LPP-së.”*

**Pretendimi i dytë (II) ankimor dhe i katërt (IV) ankimor është i pa bazuar** pasi që *“Eksperti thekson se qëllim i neni 59 është Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve fillimisht autoriteti kontraktues ka themeluar komision të Vlerësimit, pasi ka pranuar kërkesën për rishqyrtim dhe lëndën e ka kthye në rivlerësim ka themeluar komision për Rivlerësim. Eksperti thekson se qëllim i neni 72 është (mundësia e sqarimit) Dokumentacioni dhe informacioni shtesë: Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.*

*Shih pretendimin e OE ankues i njëjti pretendon se OE i shpallur fitues nuk i ka plotësuar kushtet e tenderit sepse:*

- 1. Nuk ka prezantuar asnjë referencë përveç listës së referencave.*
- 2. Nuk ka prezantuar dëshmi mbi mekanizmin e paraparë përveç listës e mekanizmit*
- 3. Gjithashtu OE fitues nuk e ka plotësuar kriterin sa i stafit teknik ku e njëjta ka dorëzuar vetëm një listë të punëtorëve kurse nuk ka dorëzuar kontratat e nënshkruar dhe të vulosura nga palët ashtu siç janë kërkuar.*

4. I njëjti pretendon se oferta e OE ankues nuk e ka tejkaluar buxhetin e paraparë sepse i njëjti thekson se ka ofertuar me metër /kub që i bie 77.00€ për metër kub që do më than se 1m kub dru =1.43 metër hapësire.

Eksperti sqaron se sa i përket tri pretendimeve të para të njëjtat janë të pa bazuara sepse kur dorëzohet lista e kontratave sipas nenit 59 ,dhe nenit 72 të LPP -së si dhe bazuar në udhëzuesin nr 001/2023 për prokurim publik konkretisht neni 10 sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve përkatësisht të rreshti i parë i kësaj tablele shkruan se:Mungon referenca/certifikata e pranimit nga lista e kontratave të prezantuar Mund të kërkojen informata sqaruese 69.OE i shpallur fitues siç e ka përmendur edhe OE ankues ka dorëzuar listat dhe AK bazuar në nenin 59 dhe 72 si dhe bazuar në udhëzuesin nr 001/2023 për prokurim publik konkretisht neni 10 sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit i ka kërkuar edhe dëshmitë për listën e kontratave për listën e makinerisë dhe për listën e punëtorëve.AK gjatë vlerësimit ka qenë i detyruar të i kërkojë dëshmitë që janë prezantuar me tri listat sepse ishte oferta me çmim më të lirë nga të gjithë ofertuesit oferta financiare ishte 382 455.70 ndërsa oferta e OE ankues ishte 453,761.00 dallimi në çmim ishte mbi 71,000.00€Andaj pasi që Listat janë dorëzuar me rastin e ofertimit kërkesat për dëshmi në kuadër të listave të prezantuar nga ana e AK ishin në harmoni me nenin 59 dhe 72 si dhe udhëzuesin nr 001/2023 për prokurim publik.Sa i përket pretendimit nr 4 të OE ankues se nuk e ka tejkaluar buxhetin e paraparë sepse i njëjti thekson se ka ofertuar me metër /kub që i bie 77.00€ për metër kub që do më than se 1m kub dru =1.43 meter hapësirë eksperti sqaron se të përshkrimi i çmimit ka qenë e përcaktuar për të gjithë ofertuesit përshkrimi i njëjtë dhe OE ankues ka ofertuar me çmim m3 siç ishte paraparë dhe sikur kanë ofertuar të gjithë ofertuesit tjerë mirëpo i njëjti ishte me çmim mbi 71 000.00€ ma të lart se sa oferta e shpallur fitues.Andaj, Eksperti konstaton se nuk qëndron pretendimi i OE ankues, sepse AK ka vepruar në harmoni me nenin 59 dhe 72 të LPP-së .”

**Pretendimi i tretë (III) ankimor është i pa bazuar** pasi që “Eksperti thekson se qëllimi i neni 62 është apo i njëjti nën sqaron se kur duhet të anulohet një aktivitet i prokurimit i cili nuk do rezultojë me dhënie të kontratës si dhe par. 1.1 tregon për rastet kur një shkelje e LPP ka ndodhur dhe nuk mundë të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor duke përfshirë rastet kur një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.OE ankues pretendon se OE i shpallur fitues nuk i ka plotësuar kriteret e parapara me NJK dhe DT dhe i njëjti pretendon se nëse Oferta e OE ankues e ka tejkaluar buxhetin e paraparë aktiviteti i prokurimit do duhej të anulohet.Eksperti sqaron se nuk qëndron pretendimi i OE ankues sepse OE i shpallur fitues siç u sqarua në pretendimin paraprak i ka plotësuar kriteret e parapara me NJK dhe DT. dhe ka ofertuar me çmim më të lirë ,sikurse u sqarua në pretendimin paraprak (2 dhe 4 lidhur me shkeljet e nenit 59 dhe 72).”

**Pretendimi i pestë (V) ankimor është i pa bazuar** pasi që “Eksperti thekson se qëllimi i këtij neni ka të bëjë me aftësinë teknike dhe profesionale.OE ankues pretendon se AK nuk ka pasur të drejtë të i kërkojë informacione shtesë lidhur me listat e dorëzuara të cilat u shqyrtuan në pretendimin 2 dhe 4 të kësaj ekspertize të njëjta pretendime nuk qëndrojnë siç u sqaruan në pretendimet e përmendura më lart (pretendimi 2 dhe 4 të këtij raporti).”

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues. Argumentimi në raportin e ekspertit është i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin

e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit.

*- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa duhet të refuzohet si e pa bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me dru dhe pelet” me numër të prokurimit 651-23-4592-1-1-1, pasi që është vlerësuar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar konform dispozitave ligjore të LPP dhe nuk është gjetur ndonjë shkelje mbi të cilat ka pretenduar OE ankues me rastin e parashtrimit të ankesës në OSHP. *OE i shpallur fitues siç e ka përmendur edhe OE ankues kishte dorëzuar listat kurse AK bazuar në nenin 59 dhe 72 si dhe bazuar në udhëzuesin nr 001/2023 për prokurim publik konkretisht nëni 10 sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit i ka kërkuar edhe dëshmitë për listën e kontratave për listën e makinerisë dhe për listën e punëtorëve. AK gjatë vlerësimit ka qenë i detyruar të i kërkojë dëshmitë që janë prezantuar me tri listat sepse ishte oferta me çmim ma të lirë nga të gjithë ofertuesit oferta financiare ishte 382 455.70 ndërsa oferta e OE ankues ishte 453,761.00 dallimi në çmim ishte mbi 71,000.00€, kurse pas vlerësimit nga ana e ekspertit i njejt i ka konstatuar se OE i rekomanduar ka ofertuar konform dosjes së tenderit.*

Bazuar në të lartcekurat përfshirë pohimet ankimore dhe gjetjet e ekspertit shqyrtues, Ankuesi ka deklaruar se i rekomanduari e kishte plotësuar ofertën e tij në të tri listat të specifikuar si më lartë, Paneli sipas gjykimit të pavarur duke u nisur gjithnjë nga aspekti logjik dhe parimor, gjykon se secili ofertues do duhej që me kohe të kujdeset për ofertën e tij duke e plotësuar të njëjtën me të gjitha dokumentet relevante të kërkuara në DT, megjithatë kjo është e lejuar sipas LPP dhe RRP dhe UPP siç është referuar si më lartë në bazë të normave të cekura, andaj rrjedhimisht paneli i cilëson si pretendime pjesërisht të bazuara dhe kësajsoj edhe pse nuk ndryshon rezultati përfundimtar i këtij aktiviteti vendosi si në pikën dy të këtij vendimi.

Përveç tjerash, vlen të theksohet se lidhur me këtë aktivitet prokurimi pala ankuese siç edhe ka pretenduar në ankesën e tij, duke u bazuar në çmimin e dhënë në ofertë, i njëjti është jashtë vlerës së parashikuar, ndërsa pretendimi ankimor në të cilin OE ankues deklaroi se nuk ka ofertuar me çmimin e dhënë, sikurse i njëjti të ishte klasifikuar si i bazuar atëherë përsëri kjo do të nënkuptonte ndryshim material si dhe në rast të korigjimit të çmimit i njëjti do të konsiderohej si i papërgjegjshëm për faktin se do të tejkalonte pragun e lejuar prej 2%, siç parashihet me legjislacionin në fuqi.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetin e prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktiviteti të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit,

qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Vjosa Gradinaj**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
- **OE - " Pylla " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: